

P R O C E S V E R B A L

Mledhja e 04e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 27.05.2020 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z. Buyar Mazrek.

Në mledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë seerdhët në mbledhjen e 04tërregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Paraqitja e raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2019
4. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së ekzekutivit për vitin 2020
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 dhe 2019 në vitin 2020
6. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë, a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 14

-Jo 0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu në rend te ditës nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime rendii dites u pranua.

3. Paraqitja e raportit të punës së ekzekutivit për vitin 2019

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu rreth kësaj pike?

Halim Sadiku:

Së pari ju përshëndes të gjithëve, kisha kërkuar prej kryetarit të komunës që reporti e ekzekutivit për vitin 2019 të jetë i detajuar më mire, këtu është shkruar gjërësisht, asgjë nuk ka detale. Unë u mundova diqka me kuptu nga ky rapport por nuk ka informata të detajuara se qka është bërë, qka është punuar, sa mjete janë shpenzuar. Renovimi i ndërtesës komunale, kanalizimi, por sa metra kanalizim, ku është bërë ky kanalizim nuk po shkruan askund. Unë kërkoj nga Kryetari që ta na prezanton report



tremujor më të hollësishëm, shembull mbrenda 3 muajve janë shpenzuar qekaq mjete për kanalizim ose ndonjë projekt tjetër, dreka zyrtare, udhëtime zyrtare, raporti thjesht me qenë më transparent. Ky reporti i ka 100 faqe por asgjë nuk është e kuartë. Faleminderit që më ndëgjuat.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Të nderuar anëtarë të kuvendit, nëse keni pytje drejtorët janë të gjithë prezent, urdhëroni.

Fuat Taç:

Ju përshëndes të gjithëve, sa i përket reportit na qe tri vite jemi duke kërkuar rapor por nuk po mundemi me marrë, unë pajtohem me Halimin, reporti duhet të jetë mëi detajuar, këtë report unë as që dua ta miratoj pra nuk po më dukët e arsyeshme, na qe 3 vjet jemi duke kërkuar report nga kryetari, mo jena lodhë. Ai e dinë fortë mirë sa herë ka kërkuar report na ne por tani personaslisht po funksionon me një sistemë krejt tjetër dhe kjo është një gabim shumë madhë për komunën tonë. Një komunë që nuk mundet me paraqit një report korrekt atëherë ky është një gabim i madhë.

Halim Sadiku:

I nderuar kryetar, i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë, unë kam një pytje për drejtorin e shëndetësisë. Mbrenda 5 minutave mundeni me i pa gabimet në QMF. Shembull nuk ka dhoma për dhenie te infuzionit dhe ky është një gabim shumë madhë, a keni planifikuar me bo një dhomë shtesë, për mendimin tim aty kemi nevojë për dy dhoma shtesë jo për një. Duhet të bisëdohet me kryetarin e komunës dhe këto probleme duhet të zgjidhen. E dyta, duhet edhe vend parkimi për rastet emergjente, vetura me pacient të sëmurë nuk mundet kurrsesi me depërtu në QMF. Unë si anëtarë i kuvendit kam parë mangësi në këto dy qështje dhe kam dashur me ju tregu edhe juve. Ne si përfaqësues të popullit duhet ti flasim dhe zgjidhim këto probleme

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Sa I përket reportit kishte qenë mirë që kryetari të na japë disa sqarime. Urdhëro Z.Kryetar.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Unë nuk pe shoh të nevojmë që të jap sqarime rreth reportit, aty po shkruan gkitqka, nëse keni ndonjë pytje mundeni me pyt. Së pari ju përshendes të gjithëve, me fat edhe festae fitër bajramit, allahu ishalla na pranon agjërimin. Sa I përket reportit Halimi kërkoi më shumë detaje. Fuati tha që nuk po na dërgoni report, ne ua kemi përcjellur reportet 3 dhe 6 mujore dhe mundeni me i pa të gjitha reportet nëeb faqet e komunës. Përmes GAP-it ju mundeni me I pa të gjitha shpenzimet për dreka zyrtare, servisimet e automjeteve, për cilin project sa mjete janë ndarë, shkruan emri dhe të gjitha detalet e tjera. Bile edhe nëinternet janë këto rapportë që më herët nuk ka pasur një mundësi të tillë. Raportin ua kemi përcjellë edhe në formë elektronike ndoshta e keni lexu, nëse kërkoni detale më tepër drejtorët janë present dhe mundeni me ju drejtu drejtorave.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Ne ua kemi përcjellin reportin me 100 faqe nësekeni lexuar e keni parë, a ka dikudh tjetër diqka me pyt, kjo pikë nuk ka me u votu, është veq njoftim për asambleistët. A ka dikush diqka tjetër me shtu, urdhëro Halim.

Halim Sadiku:

Kur kryetariishte në opozitë vazhdimisht kërkontë report nga Kryetari ndërsa tani që vet je kryetar nuk po ofron report. Unë po kërkoj dhe kam kërkuar që reporti punës së ekzekutivit të prezantohet me sllajte, të vendoset një reflektor dhe qdo projekt të spjegohet më gjërësisht. Bile edhe vetë ka premtu që nese unë bëhem kryetar kam me prezantu reportin me sllajte. Unë nuk po dua me hy nëeb faqen e GAP-it, I dua sllajtet e prezantuara nga zyrtarët e juaj. Të hyrat vetanake janë shpenzuar në x projekt, x shuma. Investimet kapitale për x projekt, x shuma etj. Shembull na 53,000€ për tri vite i bojm mbikqyrje të kanalizimeve që gjë qe ska nevojë ajo absolut hiq, ato e kisha hek meniher, 53,000€ na nuk kemi investime të kanalizimeve, qka ka me mbikqyr, kanalizimet dalin krejt jashtë. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Urdhero Z. Ruzhdi.

Rujdi Mazrek: Drejtor I Shendetësisë

Përshtendetje për te gjithë, unë desha me ju përgjigjë pyetjeve që më janë drejtuar mua. Pyetja e parë dhomat e infuzionit, pyetja e dytë parkingu në QMF. Sa I përket mungesës së dhomave të infuzionit është një problem qështë duke vazhduar që dy vite, për momentin e kemi projektin e zgjerimit të QMF-së. Në drejtim të lumit kanë me u ndërtu dhomat përmjet këtë projekt e kemi pregaditur dje ua kemi dërguar Ministrisë së Shendetësisë por pasi që QMF-ja jonë nuk po I përmblush kriteret e kërkura nga Ministria ky projekt nuk është pranuar. Tani nuk është dhënë asnjë leje për të punuar në QMF ose për ta zgjeruar kapacitetin. Sipas standardeve normale neve nuk na lejohet që të jepim infuzione aty. Pasi që Ministria nuk na ka përkrah ne kemi hartuar prop projektin dhe kemi ndare 1,400,000€ mjete për ndërtimin e Qendrës së QMF-së ne vendin e ish tregut të gjelber por pasi që për projektin në fjalë janë nevojitur shumë mjete ne e kemi hequr nga projekti repartin e emergjencav dhe repartin e Gjinekologjisë dhe projektin e fundit që e kemi hartuar ka dalë në vlerë 800,000€ dhe është miratuar. Vitin e kaluar kanë mbetur 200,000€ edhe këtë vit I kemi shtuar edhe 200,000€ dhe kemi qenë në kontakt me Ministrinë për realizimin e këtij projekti por ky projekt ka ngecur për shkak të shfaqjes së pandemisë së Coronavirusit. Kemi me qenë në kontakt edhe ministrin e Ardhshëm I cili do të zgjidhet nga Qeveria e re. Pyetja e dytështe për vendparkimin në QMF. Në vitin 2017 kur ia kemi filluar detyrën ne në QMF kanë qenë 10,000 aplikime të pacientëve, në vitin 2018 ky numër u rrit në 12,000 pacientë dhe shikuar me këta numra të pacientëve ky vend parkingu është mjaftueshëm por vitin e kaluar ne kemi pranuar 12,000 pacientë në QMF ,perveq kesaj ne vitin e kaluar numri nga 19.700 paciente ka arritur ne 40.000 se bashku me pacientet e fshatrave perreth. Ne takimet qe ie kemi relizuar me kryetarin e komunes kemmi menduar qe eshte e nevojshme qe te ndertohen një vend parkim me i madhe edhe nese eshte projekt afatshkurt ne kemi ndermend qe 4 metra ne drejtim te parkut te bejme një vend parkim. inshallah mbrenda një kohe te shkurter e realizojme kete. patjetër qe nuk eshte e mjaftueshme per 43.000 paciente. Prizreni ka prnuar 1.000.000 paciente dhe kjo është një rekord per kete komune. Ne një komunë me popullsi prej 5600 banore kemi pranuar 4200 pacientë dhe nese bejmë njenkrahasim me prizrenin shohim se i kemi kaluar ata dhe se nuk kemi mbetur shume mrapa tyre dhe eshte shume normale qe ky vendparkim nuk mjafton. po mendojmë që vitin e ardhshem me buxhetin shtese te drejtorise dhe me takimin qe do ti realizojme me ministrinë ky projekt do te perfundoje. Faleminderit.

Halim Sadiku

I nderuar drejtor, me keto sqarime qe na ofruat mua nuk ma mbushen aspak mendjen, keto jane arsyte dobeta, qytetaret kerkojne sherbin nga ne. Nese ju i keni kontrolluar 12.000 paciente atehere perse nuk e keni marre kete raport dhe se bashku me kryetarin me shku ne ministri dhe me u anku. Ju zyrtarisht duhet me kerku prej tyre hapjen e emergjencave i cili duhet te jetë i klimatizuar dhe ti kete te gjitha kushtet e një emergjencë.

Rujdi mazrek:

Ministria e shëndetësisë neve na kanë thënë që ju nuk keni te drejtë të jepni infuzion, si dhe pacientët duhet ti transferoni në spitalin regional të Prizrenit. Na per mos me i bart pacientet ne Prisen po i jepim infuzione ketu, ne për detyrë e kemi vetëm ingjeksione me i dhënë. Ato shtretër janë vetëm për ingjeksione.

Halim Sadiku

Atehere ketu duhet me qene reparti i emergjencave.

Rujdi mazrek:

Javen e ardhshme ua prezantoj shkresat që kemi bërë me ministrinë.

Yalcin Mazrek

Pershendetje per te gjithe, une kam një pyetje per drejtorinë e sherbimeve publike, mendoj qe duhet të na jep spegime me tepër për dy qeshtje. Për mirembajtjen e shtyllave elektrike janë ndarë 20.000 euro, ku janë bërë këto punë dua ti di, e dyta 130.000 euro per mirembajtjen e rrugeve.

mbrenda vitit 2019 ku janë kryer këto punë. Pasi që në raport po shkruan besoj që e din se ku janë shpenzuar këto mjete. Faleminderit.

Tarkan mazrek

Pershendetje per te gjithe, sa i perket pytjes per mirambajtjen e shtyllave elektrike, numër 1 jqnë përreth stadiumit, e dyta janë tek pjesa ka shtëpia e anëtarit të kuvendit Z. halim, 3 lagje janë aktivizuar katër shtylla, pra rrëth 85% apo 90 % e ndriqimit publik janë aktiv. Në vitet e kaluara këto lagje nuk kanë pasur ndriqim ndërsa tani janë duke funksionuar të gjitha.

Sibel Mazrek.

Ju thate per lagjen e mesme, a mundeni me na tregu per ku po behet fjale?

Tarkan mazrek

Ne vendin ku eshte vendosur tensioni i larte, pra ne lagjen e gjungave qe i thojme ne. Këtu nuk duhet mi mendu vetëm shtyllat elektrike sepse aty perfshihet edhe mirembajtja dhe unstawimi kabllove. Kalojme tek pergjigjja ne pyrtjen e dyte, e dini që në lagjen tonë mblidhej uji dhe ne deri tek shtëpia e fadikos kemi vendosur kanalizim , kemi shtruar edhe ne lagjen poshtë, kah shkolla, gjithashtu kemi shtruar kanalizim, ky kanalizim e ka edhe mirembajtjen, kemi shtruar edhe kubeza, në lagjen tonë kemi renovuar kubëzat pra në 4 apo 5 vende kemi punuar.

Fuat tac

Duam ta dimë sa metra kanalizim keni vendosur

Tarkan Mazrek

Nuk kemi informata sa metra veq në total tenderi ka qenë 330.000 euro dhe me këto mjete 3 vite do tëmirëbahren kanalizimet.

Aysel Morina

Edhe unë kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike. Në lagjen tone janë mbyllur dy kanale, kush i ka prish edhe pse i kanë prish sepse e tërë lagjja kanë dëme nga nkjo mbyllje si fabrika e xhamave dhe serat afër.

Tarkan MAZREK

Këto kanale mbrenda një kohe shumë të shkurtër do të hapen por ky problem i kanalizimit ka qenë edhe më herët. Ky kanalizim nuk eshte ndertuar ne kohen tone, janë vendosur më herët dhe tani po shkaktojnë telashe. Ne mbrenda një kohe shumë të shkurtër do ta hapim këtë e kemi edh projektin e gatshëm.

Necmedin Morina

Nje minut drejtor, mos i gjuj askujt llafe këtu, e para jeni drejtor dhe nuk po e dini sa metra kanalizim janë vendosur nga shtëpia e Latifit deri tek lumi. Po ju tregoj unë, 50 metra kanalizim janë vendosur. Kur te del në foltore me fol duhesh me qenë i pregaditur mire.

Tarkan Mazrek

Tek shtëpia e Latifit kemi shtruar 200 metra kanalizim dhe unë nuk jam i detyruar me ju pyt juve sa kanal kemi shtruar, juve vetëm ju raportoj.

Necmedin Morina

Ju nuk po dini me pregadit raport dhe une kam te drejte qdo minut me kerku raport nga ti ede me ju pyt. Z. Tarkan bëhu pak më i kujdeshëm dhe më i sjellshëm sepse neve populli na ka sjellë këtu

Buyar Mazrek

Julutem, qetësohunu.

Tarkan Mazrek

NE ua kemi derguar reportin dhe nese nuk e keni lexuar eshte problemi juaj, ne nuk po jetojme në Amerikë, kemi shtruar kanalizime, ndriqimi është aktiv.

Ilyas Bayraktar

I nderuar kryetar, kryesues, drejtorë dhe pjesmarrës tjerë, nuk keni nevojë me shkaktu kacafytje këtu. Ne po kërkojmë raport dhe ky raport është dashur me qenë më i detajuar. Po të kishte qenë më i detajuar në nuk kishim pasur probleme. Nëse nuk është shkruar në raport që janë shtruar 300 metra kanalizim atëherë ne kerkojmë llogari për këtë.

Necmedin morina

Janë msu këta mos me kërku asnjëherë llogari nga këta por sot do të kërkojmë

Ilyas Bajraktar

Qe tri vite neve nuk na është ofruar asnjë raport, sot na është ofruar dhe qdokush ka të drejtë të kërkojë llogari. Nëse thoni a ka pasur problem me kanalizim edhe më herët, po ka pasur. **Edha tani ka problem.** Nësee shikoni me kujdes 20.000€ janë ndarë për ndriqim publik por veëtqm mirëmbajtaj e tyre është bërë, shtyllat nuk janë ndërruar. Sot le ti paraqesim problemet qëi kemi dhe të mundohemi ti zgjedhim ato, nëse është nevoja të ndajmë edhe buxhet shtesë. Raporti është prezantuar por të gjithë po e shohim që në raport ka disa mangësi. 40,000€ nuk kanë shkuan ndoshta në mirëmbajtjen e parqeve, kérko llogari, nëse nuk e di atëherë nuk është e nevojshme të shkaktosh zhurmë dhe kacafytje. Askush nuk mundet me i bërë presion askujt duke bërtitur. Të gjithë e ekemi lirinë e shprehjes.

Buyar Mazrek:

Asambleja mundet me qenë vendi i diskutimeve por nuk ka nevojë për zhurmë.

Ilyas Bayraktar:

Le të pyesim për 330,000€ ku janë shpenzuar por nuk ka kuptim me shkaktu zhurmë dhe probleme. Shikuar nga aspekti tjetër ky është një sukses i madhë sepse në të kaluarën as që na u ofrojke një raport i tillë. Faleminderit.

Buyar Mazrek:

Këtu është vendi për diskutim dhe per zgjidhjen e problemeve e jo për kacafytje. Të gjithë jemi të afërm me njëri tjetrin, turp është.

Necmettin Morina:

Qdo Drejtor perderisa ka me raportu duhet me qenëi pregaditur

Tarkan Mazrek Kamu Hizmetler Müdürü:

Dokumentet i ke përpра, lexoji, e nese nuk din me lexu atëherë nuk kam qka me ju bo. Hapini, lexojini, para vetes i keni të gjitha dosjet.

Necmettin Morina:

Shikoni kolegë unë po turpërohem nga një kryetar dhe nga një bort të drejtorav siq e kemi ne. Me qfarë stafi po punoni? Unë nuk po mundem me kuptu, drejtori juaj ka ardhur këtu po raporton kinse por në faktë nuk dinë asgjë. Ne po i shohim veprimet dhe reagimet e secilit drejtor. Turp për drejtorin që para të gjithëve po sillet keq.

Buyar Mazrek:

Para vetes e keni raportin me 90 faqe që ua kemi dërguar por me sa po mundem me e kuptu askush nuk e keni hapur as me lecu bile një fjalë, po ta kishit lexuar kishit qenë më të pregaditur. Nëse doni unë mundem me ju printu të gjithëve.

İlyas Bayraktar:

E ka lexu por po pyet se ku janë shpenzuar 330,000€, raporti eshtë por nuk ka detale.

Buyar Mazrek:

Kryetari komunës e ka paraqitur raportin por nëse ju nuk e keni lexuar fajin nuk e ka ai e as drejtorët, nëse doni ua sjellë të gjithëve raportin.

İlyas Bayraktar:

Raportin që do e sjellësh ti a ka ndonjë dallim nga ky raport?

Buyar Mazrek:

I njëjtështë por ju nuk e keni lexuar, lexojeni.

Necmettin Morina:

Atëherë sa metra kanalizim janë vendosur?

Meclis Yöneticisi Buyar Mazrek:

Metrat ne nuk i dimë.

Necmettin Morina:

Atëherë qka po punon, cila është puna juaj si drejtor?

Meclis Yöneticisi Buyar Mazrek:

Detalet janë në raport.

Yalçın Mazrek:

Unë pyeta vetëm që raportin që na kanë dërguar neve nuk shkruan ku dhe sa mjete janë shpenzuar për projekt të kanalizimit, a është shtruar 1000 metra apo 5000 metra.

Meclis Yöneticisi Buyar Mazrek:

Drejtori e spjegoi që ka pasur vetëm renovim.

Yalçın Mazrek :

Faleminderit, e mora përgjigjen.

Meclis Yöneticisi Buyar Mazrek:

Në rregull, a ka dikush tjetër me marrë fjalën? Urdhëro Halim.

Halim SADIKU:

Drejtorët duhet me qenë më të pregaditur sepse na nuk jemi profesional, e pranoj këtë. Këtu të gjithë jemi në nivel dhe kategori të njejtë, këto punë ban edhe kadal dhe me kujdes të realizohen por drejtoret duhet te na japid llogari neve. Ne jemi aëtarë të kuvendit dhe kemi të drejtë me pyt. Unë personalisht nuk kërkoj shumë detale, shembull ndriqimi, sa poqe elektrike janë vendosur, sa metra ,

sa ka qenë kostoja, 5 metra kanaalizim, sa thellë ka qenë, sa ka qenë kostoja , ky është raport i detajuar që po kërkoj unë. Nuk keni nevojë me u nervozu e as me u grind ndërmjet veti. Të gjithë jemi në kategori të njejtë. Ne mundemi deri në mrëmje me i mbajtë drejtorst dhe me i pyt për qdo gjë. Nuk po dua me përsërit përsëri por një gjë ta dimë që kur të dalim para qytetarëve të dimë me ju përgjigj atyre.

Buyar Mazrek:

Faleminderit Z. Halim. A ka dikush tjeter diqka me shtu, urdhëro Z.Fuat

Faat Taç:

Drejtorii Shëndetësisë na ofroi sqarime por neve nuk po na intereson se qka do të bëni në të ardhmen por qka keni bërë deri tani. Ku keni bërë shpenzime. Projektet qëi planifikoni i sillni tek ne dhe ne e miratojmë, shumë e thjeshtë. Shembull janë shpenzuar 100,000€ por nuk ka detaj për këtë shpenzim, patjetër duheni me na spjegu. Pasi që nuk e ke shkruar në raport atëherë duhesh me ardhë edhe me na spjegu, duhet të mësohesh të ndëgjosh, të ofendohesh e jo të thuash jo menaxhmentii vjetër e nuk e ka bërë këtë dhe për këtë arsyet rënë. Me drejtorët tanë nuk kemi përjetuar kësi probleme, ne këtu kemi buxhet dhe unë nuk kam të drejtë ta pyes kryetarin sa buxhet keni kërkuar nga drejtoria përkatëse. Neve po na intereson ku janë shpenzuar mjetet, jo ti me na thënë kemi krkuar kaq para nga Ministria, nuk kam kohë me ndëgju, ju realizoni dhe populli e sheh. Ju po thoni që nuk mundemi me i dhënë infuzion por me ligj nuk është e lejuar QMF-ja as tri ndërrime me punu, ku po ju konvenon po thuani sështë e lejuar me ligj ndërsa ku po ju konvenon po vazhdoni sipas mendimit tuaj. Ne po e pranojmë që kjo është një politikë por drejtori nuk duhet me bë politikë, drejtori duhet me raportu. 300 000€ ne ti kemi miratuar dhe pëgas një viti ju kërkojmë llogari, kemi të drejtë ta dijmë se ku i keni shpenzuar ato. Këro para nuk i kam dhënë nga xhepiim, janë para të publikut dhe qëllimi takimit tonë këtu është që sa më mirë dhe sa më drejtë ti shpenzojmë këto mjete. Unë pyes sa dua por nuk keni nevojë me u nervozu, ju duhet vet me i pa gabimet e tua.

Necmettin Morina:

Së pari ndrqimi qe 12 vite nuk ka funksionuar, përsë nuk po ndizen llambat sepse kur janë bërë pranë xhamisë janë këputur kabllot. Ju mos bazohi në menaxhmentin e kaluar, përqëndrohuninë menaxhmentin e tanishëm, je pozitë menaxhoji gjërat si duhet. Jo vazhdimisht me cekë menaxhmentin e vjetër. Mos mendoni që nuk po i shohim dhe nuk po i dijm ë gjërat.

Abdül Krasniç:

Të nderuar anëtarë, keni kërkuar raport nga secila drejtori dhe qdo drejtori ua ka ofruar atë. Yalçini bëri një pyetje por unë nga dita që kam filluar deyrën si kryetar jam munduar të mos bëjë dallime, ju kam ndëgjuar të gjithëve, kemi pasur edhe gabime dhe të drejta, asnjëherë nuk kam thënë qëi kemi realizuar të gjitha gjërat 100%. Tarkani pak a shumëiu përgjigj pyetjeve të Yalçinit, 330,000€ janë pëtri vite jo për lvit.

Necmettin Morina:

I nderuar Kryetar, ne po jetojmë në Mamushë dhe po shohim gjithqka qka po punohet dhe qka po realizohet.

Belediye Başkani sn: Abdül Krasniç:

Ne mundemi me pasëshumë mangësi, unë personalisht nga dita që kam garuar për kandidat të kryetarit jam munduar që asnjëherë të mos bëjë dallime, me anë të një partije kam ardhur këtu , jam përfaqëuar nga një parti dhe me njerëzit e një partie jemi këtu. Sot je kryetar i komunës por një ditë mundesh edhe mos me qenë, ka dy rrugë ose shkarkohem vetë ose më shkarkojnëtë tjërët sepse këtu nuk është malli babait tim. Askush nuk ka gjasa të realizojë 100 %. Sa i përket ndriqimit Yalçini e ka kuptuar gabim. Qdo ditë po shohim që po shkaktohen defekte, ndonjëherë po thehen shtyllat, nganjëherë nuk po punojnë llambat elektrike, po duhet me i vendos shtylla të reja, shtyllat e vjetra nuk i kemi hedhur por i kemi grumbulluar në një vend, i përdorim edhe to. Një aksident ka ndodhur dhe janë shkaktuar dëme në vlerë 1000 euro. Sa i përket raportit qdo drejtor është munduar ti paraqesë sa

më mire projektet dhe aktivitetet e realizuara. Disa drejtorë punojnë në rajon, disa ne zyrë. Si ekip po mundohemi me siguru perkrahje nga Ministri të ndryshme. Një shokë nga Turqia ma uroj festën e bajramit dhe më tha që Mamushën kanë mbetur veq edhe kërcyllat me sulmu sepse tanat të kqijat i ka pas, tërmet, reshje, kokrriz, tash edhe pandemia. Ne këtë qështje e kemi adresuar në këtë botën. Pas reshjeve Mamushën e ka vizituar Kryeministri Albin Kurti, Ministri i Bujqësisë dhe kemi kërkuar përkrahje nga ata. Sot në ora 11 kanë me ardhë komisioni nga Ministria e Bujqësisë dhe do ti verefikojnë dëmet në vendin e ngjarjes. Ne do ti informojmë qytetarët që ata duhet ta paraqesin dëmin në komunë mandej komisioni do të bëjë verifikim e tyre. Para 2 viteve nuk kemi vvepruar kështu dhe ka pasur padrejtësi në shpërndarje të mjeteve. Sa i përket QMF-së u përgjigji Ruzhdiju. Në oborrin e QMF-sështë vendosur tenda dhe kjo na ka shkaktuar telashë. Pa përfundimin e ndërtësës së xhamisë nuk po mundemi me punu në park. A ka nevojë që raportet të jenë më të detajuara, ka, mundet me pasë edhe mangësi. Unë si kryetar i komunës qdo vit ekam prezantuar raportin e punës ndërsa sa i përket problemit të kanalizimit që e ceki Ayseli, unë nuk mundem me shit arën time edhe me e zgjidh këtë problem, nganjëherë nuk po ekzistojnë mundësítë.

Necmettin Morina:

Por sjellja e një drejtori në këtë mënyrë a është e drejtë apo e gabuar?

Abdül Krasniç:

E gabuar.

Aysel Morina:

Ato kanale qe dy vite janë të mbyllura.

Abdül Krasniç:

Mundet me qenë më pakë se një vjet, problemii kanalizimit ka qenë edhe para se me i ndërtu ato sepse Mamusha ka problem me ramje, i kemi të vendosura 2 gypa 60 centimetërshe, njëri po punon me gjysëm kapaciteti kurse tjetri është mbyllur. Kanalizimet duhet ti trajtojmë me urgjencë, unë edhe vitin e kaluar kam thënë që ne projektin e kemi të gatshëm. Projektin e kemi hartuar, nga shtëpia e të ndjerit Haci Cafer deri tek lumi po kushton 330,000€ por nuk kemi mundur me siguru mjete. Ky projekt në vlerë prej 330,000€ duhet të përfundojë menjëherë. Kemi probleme edhe ma kanalizimet para ndërtësës së komunës, siq e theshtë që herët mrenda 3 viteve kemi përjetuar shumë gjëra të këqija. Të nderuar pjesmarrës ky ështëraporti, a keni diqka me pyt?

Buyar Mazrek:

A ka dikush tjetër diqka me shtu lidhur me raport, nëse jo atëherë kalojmë në pikën tjetër sepse rapporti nuk ka me votu

4.Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së ekzekutivit për vitin 2020

Buyar Mazrek:

Nëse keni ndonjë propozim drejtorët janë prezent, urdhëroni, nëse jo atëherë votojmë për këtë pikë.

Me vota unanim kjo pikë u pranua.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2018 dhe 2019 në vitin 2020

Buyar Mazrek:

Sa i përket kësaj pike informata do na ofrojë kryetari komunës Z. Abdülhadi Krasniç.

Belediye Baškani sn: Abdül Krasniç:

her yıl olduğu gibi bu yıl'da sona doğru son 3 ayda toplanan vergiler projelerde kullanma şansımız kalmıyor, ve bunlar bakanlığa geri gitmez bu nedenle diğer yıla aktarırız. Bazi yıllarda para kalır biz projeyi hazırlarken bazı bakanlıklar bizden katkı payı ister: diyelim ki mühendis bir projeyi 100 bin avro çizmiş ihalede 70 bin avro çıktı, bakanlık burada bizden belli miktarda katkı payı ister burada 2018 yılı ve 2019 yılının'dan kalan paralar aktarılıyor burada harcanamayan paralar 44 bin avro civarında, diğer belediyeler bunları 1. ve 2. ayda harcadı ve pandemi döneminde vatandaşlara malzeme yardımı olarak harcadı. Bizde ise Allah'a çok şükür durumumuz daha iyi çok fazla ihtiyaç olmadığı en azından diğer yardım kuruluşları 30'ar 50'ser paket yardımında bulundular, bu paraları buraya harcamadık geçen yıl bütçe hazırlanırken domates Festivali ile ilgili bir planlama yapmıştık. Domates festivalin de 52 bin avro civarında geçen yıl vatandaşça destek sağlandı. Bu yıl o toplanan gelirlerden 24 bin eurosunu buraya eklemeyi düşündük. Festivali 52 artı 24 eder 76 bin Euro eder. Biz bu rakamı artırmayı düşündük festival olur olmaz belli değil, bu virüs nedeniyle ama en azından biz hazır bekleyelim. Temmuz ayında normal hayatı döner isek tabii ki sizinle gene burada dansarak Festivali yapacağız mı yapmayıcağız mı o zaman konuşuruz. Temmuz ayında olmaz ise ya tarihi erteleriz ya da diğer aylarda yaparız. Ayrıca 2019 yılın'da Mamuşa Belediyesi'nin performans raporuna göre belediyemize bir gelir geldi, bu rakam Demostan 11.261 avro para geldi. Biz bu para'nın bir kısmı ile Mamuşamız'ın temizlikte ihtiyacı var Sisterne almayı düşündük. Biz bunu bu projenin adını böyle verdik ama bu sisterne 16 bin euro civarında. Biz bunu ihalede açacağımız belki adam 10.000 avro verir. Biz 16 bin avroyu garanti altına lazımlı, oradan da 4739 Avra oraya aktarmamız lazımdır. Eğer ihalede 16 binden aşağıda ise o para gene bize kalır geri dönmez. Bunun dışında konuşduğumuz o kanal sorununu acil bir şekilde çözeceğiz, 60 santimlik olan kanalı açacağımız kalan parının 15.276 Euro'luk kısmını buraya aktarmayı düşünüyoruz biz en azından düşündüğümüz o büyük kanal projesini hayatı geçirmeyi düşündük bununla bu sorunu hallederiz. Büyük projemiz 330 bin avro 2 metrelük kanal döşemesi 24.000 Euro Festivali 15000 Euro kanalizasyona 4 bin avro sister neye...

Fuat taç:

A mundem me ju pyt diqka? Vitin e kaluar i kemi bartur 22.000 € dhe sipas informatav që kam marrë unë personalisht, përfituesit e vitit të kaluar nuk mundon me përfitit këtë vit, a po, pasi qështë ashtu atëherë me pjesën e betur let përfitojnë të gjithë, sipas mendimit tim ne po shpenzojmë shumë përkëtë.

Belediye Başkanı sn: Abdül Krasniç:

Me këto mjete nuk mundon me përfitit të gjithë bujxit.

Fuat Taç:

Ne qytetarëve po u ofrojmë dhurata kurse në anën tjetër kemi problem me kanalizim, pasi që kemi ankesa rreth kanalizimit përsë atëherë ne nuk bartim mjete. Ju vetë thatë që nuk kemi para por tanë po kërkon që të barten 24,000€, me këto para mundesh bile sado pak me e zgjidh problemin e kanalizimit sepse 100,000 € nuk mundesh kurrë me i siguru.

Belediye Başkanı sn: Abdül Krasniç:

Ne me këto 24,000€ nuk mundemi me e zgjedh problemin e kanalizimit por nga ana tjetër mundemi me i përkra disa bujk. Ndoshta mundemi me i përfundu 10 metra apo 20 metra kanalizim por kjo nuk e zgjidh tërë problemin.

Fuat Taç:

Kanalın 1 metersh që po thuani nuk ka gjasa me realizu sepse ne kemi problem me ramje, ju shumë mirë e dini kur kemi dashur ne me vendos kanalzimin në drejtim e fshatit Medvecë por nuk ka pasur ramje. Mbrenda stafit ju nuk keni as inxhinier.

Abdül Krasniç:

Înhinieri e ka hartuar projektinu, prej shtëpisë së të ndjerit Haxhi Cafer deri tek lumi dhe ksnë tthënë që ka një ramje shumë të vogël, ata ia kanë bërë matjet, tanë unë besoj se qfarë thonë ata. Na edhe mjek nuk kemi por sipas filozofisë tënde ne nuk duhet të shkojmë tek mjekët tjerë. Ne këtu jemi duke punuar për të mirën e Mamushës dhe ky festival do të mbahet për qytetarët tanë. Ju vitin e kaluar keni thënë që 52,000€ janë pak ti ndajmë 100,000€ por vitin e kaluar nuk kemi pasur mundësi dhe nuk kemi mundur me realizu. Unë jam pro për ofrimin e 76,000€ për bujqit sepse këto janë parët e qytetarëve dhe le të përfitojnë ata. Përfituesit e vittit të kaluar këtë vit nuk do të marrin pjesë në garë.

Nehat Taç:

Sipas mendimit tim 76.000€ për bujqit janë pak. Unë kërkoi që kryetari të gjejë burime dhe ky numër të jetë 100,000€. Edhe vitin e kaluar ka qenë problemi i njëjtë i kanalizimit por kur e kemi bërë bartjen prej 30,000€ as ti as unë nuk kemi qenë kundër.

Fuat Taç:

Sot po vijnë plot ankesa rrëth kanalizimit, unë po tham që ta hapim kanalizimin dhe ju si kryetar i komunës duhet me i dhënë përparësi këtij problemi.

Meclis Başkanı Buya Mazrek:

Urdhëro Yalçın.

Yalçın Mazrek:

Të nderuar anëtarë, kryetari po na pyet që ti bartim apo mos ti bartim 24,000€ në festival, ai po thot që me 24,000€ nuk zgjidhet problemi i kanalizimit, aty duhen 300,000€. Ne edhe sikur qdo vit ti bartim nga 24,000€ pas 12 viteve bëhen 300,000€ dhe përfundon zgjidhja e problemit të kanalizimit. Aty 130,000€ për kanal janë, na për këtë arsy po kërkojmë më tepër sqarime, sa pare kanë mbetur. Ky nuk ështu një sukses. Kryetari popropozon bartjen për festival kurse Fuati po propozon për kanalizim. Këtu ni vendim duhet me marrë ose nëse dikush tjetër ka ndonjë propozim mundemi edhe me i bartë në ndonjë projekt tjetër.

Aysel Morina:

Pasi që për shkak të kanalizimeve nuk kemi prodhimit të domateve nuk ka nevojë as për festival?

İlyas Bayraktar:

Të nderuar anëtarë, këtu bëhet fjalë për bartjen e mjeteve në dy projekte, njëri për festival kurse tjetri për kanalizim. Sipas mendimit tim nga festivali përfitojnë disa persona por nga kanalizimi përfiton një zonë e gjërë dhe unë jam për kanalizim. Nëse pyetni se qfarë ka bërë menaxhmentii vjetër atëherë unë do ju përgjigjem, rrymën që po e shfrytëzojnë bujqit ne e kemi realizuar. Sot nëse ti me modele te reja TË VETURAVE MUNDESH ME shku deri ne arëeshtë në saje tonën. Le ti ofrojmë bujkut përkrahje për qka ka nevojë, 70,000€ janë pak, le të bëjmë projekt 100,000€ por mos ta lëmë anash edhe kanalizimin sepse qytetarëve po ushkakton dëme në shtëpi. Mamusha është e të gjithëve, nëse 330,000€ i ndajmë në tri pjesë atëherë ky problem përfundon për tri vite.

Yalçın Mazrek:

Kjo nuk bëne kështu sepse rruga nuk mund të lihet e hapur 3 vite radhazi, kjo duhet të mbyllët menjëherë, projekti si të nisë duhet me përfundu.

İlyas Bayraktar:

Tenderi hapet me 330,000€ por Operatori ekonomik mundet me marr me 150,000 projektin dhe ne këto 150,000€ mundemi sot me i siguru. Haptaz po ju them se më e rendësishme se kanalizimi nuk është asgjë, nga festivali mundet me përfitë një person por nga kanalizmi e tërë lagjja përfiton.

Yalçın Mazrek:

Shumë thjeshtë atëherë kur të bëhet rishikimi buxhetit në qershor mundemi me shyqrtu këtë qështje.

Faat Taç:

Unë kam një propozim, a të shikojmë fituesit e motokultivatorëve vitin a i kanë shitur ato apo akoma i kanë në përdorim?

Halim SADIKU:

Këtu duhet me qenë dy rregulla, e para mungesa e buxhetit dhe e dyta keqmenaxhimii këtij buxheti dhe nga këto gabimet neve po na lindin problemet. Kryetari duhet me bashkëpunu me neve, duhet me zgjidh problemin më prioritar. Shembull në vitin 2020i kemi 10 prioritete dhe përqëndrohemë më tepër tek këto. Tani Nehati qohet edhe thotë që të regjistrohen, unë jam këtu për ti përkrahur bujxit e Mamushës e jo pér bujxit e Smaqit. Neve populli na ka votuar pér këtë gjë por përgjegjësia dhe gabimii përkasin më tepër kryetarit por gjithashtu edhe neve.

İlyas Bayraktar:

Unë desha me ju përgjigj Halimit, neve populli na ka zgjedh pér me i zgjedh problemet e tyre. Une dhe ti po mirremi me tregëti dhe nuk po i zgjidhim problemet e tyre. Ne këtu 15 anëtarë nuk po mund të mirremi vesh ndërmjet veti kurse po ti mbledhim edhe përfaqësuesit e lagjeve bëhet nami.

Faat Taç:

Ne kemi problem me kanalizim, 10 shtëpitë e reja kah Torajda nuk kan kanalizim. Le të formojmë një komision dhe tëshikojmë siështë puna me përkrahjet e marra nga Qeveria. Obligimii komunës është me ndërtu kanalizime e jo me shpërnda para. Nëse janë 84,000€ atëherë kjo shumë mundet me mbulu shpenzimet pée hapjen e kanalizimeve në kënë zonë.

Nehat Taç:

Me kanal 60 cm kjo punë nuk kryhet. Serrave te 5 apo 6 personave i kanë shkaktuar dëme të mëdha. Aty nuk mundet me ngre ujin kanali 1 metersh bile qfarë kjameti ka qenë atë natë.

Aysel Morina:

Ju pëershendes të gjithëve, unë dua ti përgjigjem Nehat Taçit. Uji që po del nga ai kanal po hynë nëpër shtëpitë tona dhe aty nuk po jetohet. Prej se janë ndërtuar ato sera me qëllim që të mos shkaktohen dëmë serave ato kanale janë mbyll dhe i gjithë ujii serave nuk derdhet në rrugë. Qka na duhet festivali, motokultivatori pasi nuk mund të rritim domate.

Yalçın Mazrek:

Për të fundit herë unëi kam edhe dy propozime, kryetari po thot që të barten pér festival kurse fuati kërkon pér mirëmbajtjen e kanalizimit. Për kanalizim ashtu ashtu janë 17.000€, ti bartim edhe këto 24,000€ dhe po bëjnë 30,000-40,000€ plus edhe 56,000€ janë paratë e mbetur nga të hyrat vetanake nga vitet e kaluara total po bëhen 100,000€. Le të na përgjigjet Kryetari a mundemi me këto mjete me përfundu kanalizimin, a mundemi me ndërhy në ndonjëren pjesë?

Abdülhadi Krasniç,

Ne nuk kemi shanca me i bartë 100,000€. Këto 50,000€ që kanë mbetur nuk janë vetëm pér kanalizim, janë edhe pér kubëza ku firma është duke punuar deh duhet të paguhet. Unë nuk kam mundësi me shit arën time edhe me i pagu ku në fakt e kam shit arën dhe akoma nuk po mund me i marrë paret. Me 24,000€ qëi bartim nuk e zgjidhim problemin e kanalizimi. Nëse do ti shton 15.000€ plus 24,000€ bëjne 39,000€, me 39,000€ na duhet me ndërhy urgjent në 5 lagje.

Fuat Taç:

Siguromi 30 000€ mua dhe unë e regulloj atë kanalizim.

Nehat Taç:

Përse nuk i keni bërë më herët kanalin sepse edhe makineria ime në vend të punës ka pësuar dëme, ai kanal është shtruar në kohën tënde, përse nuk jeni kujdesur?

Fuat Taç:

Ato kanalizime janë shtruar para neve.

Buyar Mazrek:

Ju lutem mbani pak qetësi sepse kryetari e ka fjalën, ju edhe po kërkon raportim edhe nuk po ndëgjoni fare.

Semra Morina:

Në rregull, po i përkrahni bujqit por dëmet që janë shkaktuar në amvisëri, qka do të bëhet me to?

Abdülhadi Krasniç,

Ministri i bujqësisë po i përkrah vetëm bujqit, viteve të kalura qeveria i ka ndihmu edhe qytetarët që kanë pasur dëme në shtëpi.

Çamil MAZREK:

Në Mamushë ka problem me kanalizim edhe në rrugën që shkon për në fshatin Tërrnje .

Abdülhadi Krasniç,

Unë personalisht e kam parë që kanalizimet aty janë duke funksionuar. Propozimiim i fundit është që të barten mjeten bazuar në vendimin që e kemi marrë. I bartim edhe në projekte tjera por nuk zgjidhet asgjë dhe në vend që paraja të shkojë diku tjetër bile let fitojnë bujqit. Për kanalizim veq janë 15 000 €, nga 2 kanalet njëri nuk funksionon. Në vendin ku po thotë Ayseli ato kanalizimet edhe para se mu ndërtu serat kanë qenë të bllokuara. Gjatë asfaltimit ndoshta nuk kanë pasur kujdes apo ndonjë qytetar duke bartur dhe për në fushë nuk ka pasur kujdes, aty ka bllokim dhe më e rëndesishmja për neve është që ta hapim atë kanall. Përveq kësaj për me hap kanalin tek Haci Caferi lidhen dy gypa 50 cm dhe një 30 cm. Ne edhe verën e kaluar jemi munduar që ti hapim këto kanalizime. Nga ana tjetër përderisa jam unë kryetar komunë nuk lejoj që nga 10 metra apo 20 metra të shtrohen kanalizim sepse ajo rrugë përdoret nga 1000-10,000 persona nuk ban me e lënë hapur. Lutja ime është që 24 000€ të bartën përfestival sepse shumica e mamushës janë duke u marrur me bujqësi. Gjithashtu do ta blejmë cisternën 10.000 kg dhe do të mundësojmë pastrimin e të gjitha rrugëve të Mamushës. Faleminderit.

Iliyaz Bayraktar:

Inderuar kryetart, nëse është fjala për urgjencë ne ashtu ashtu i kemi në dispozicion 200,000€, aty është mbyll kanalli dhe askush nuk po ndërmerr asgjë për ta hapur. E dyta ato serat që janë ndërtuar aty në rregull por nuk është e drejtë që ujii të gjitha serave të derdhet në rrugë. Ju lutem let mirren inspektorët me këtë qështje. Kemi aq shumë mangësi sa që 24 000 nuk zgjidhin asgjë.

Abdülhadi Krasniç,

Dua me shtu edhe diqka tjetër, tanë në buxhetin e komunës na kanë mbetur 50,000-60000 € buxhet si dhe 200,000€ e ndara për Arsim por këto janë vetëm për arsim, nuk mundemi me i bartë diku tjetër.

Iliyaz Bayraktar:

Inderuar kryetar, ne nuk kemi met kap përfytë edhe nuk kemi met vënë në situatë të vështirë, në muajin e 6-të vjen rishikimii buxhetit edhe e shohim se qka bëhet deri në fund të vitit.

Buyar Mazrek: Votojmë për pikën e 5-të.

Me vota unanime është votuar edhe kjo pikë.

6.Të ndryshme

Buyar Mazrek:

Aka dikush diqka me shtu në të ndryshmet?

Ilyas Bayraktar:

Kishte me qenë mirë që te formohet një komision dhe të dal në vendin e ngjarjet për ti verefikuar dëmet e shkaktuara nga reshjet dhe breshëri. Herën e kaluar janë kompenzuar shumë qytetarë që nuk e kanë merituar. Qështja e dytë, tek zarrfikësat vazhdimisht uji po rrjedhë në rrugë, po ta kishte derdhur një qytetar këtë ujë në rrugështë ndëshkuar por komuna nuk duhet ta bëjë këtë. Qështja e tretë, vendosja e trafeve a po bëhet sipas dëshirave të personave, a nuk po verifikohet zona, Faleminderit. Sevgi Mazrek:

Siq e tha kryetari 90% e qytetarëve mirren me bujqësi, 10 % prej tyre mirren me blegtori ndoshta, a mundeni me dit sa % mirren me bujqësi edhe pasi që po kompenzohen dëmet e shkaktuara në bujqësi dhe shtëpia kush do të paguaj dëmet e shkaktuara në blegtori?

Halim Sadiku:

Ne të gjithë këtu jemi përfaqësues të popullit dhe po tëishte ndonjë qytetar ka pasë të drejtë të na bëjë pytje por shqyr që nuk ka prezent sepse ishin gërdit prej neve. Kishin kesh me neve. Ne e dimë që buxheti nuk është duke u menaxhuar mirë sepse po tëishte menaxhuar mirë këto pyetje nuk ishin bërë tani. Qe tri vite kamerat nuk po funksionojnë, qdo ditë ka vjedhje. Unë po i pyes zyrtarët përgjegjës përsë nuk punojnë kamerat, kush është përgjegjës pér këtë, duhet me dhënë llogari dikush. Sa i përket menaxhimit, kryetari dhe nënkyetarët kanë përgjegjësi ndaj qytetarëve atëherë do të lindin konflikte. Unë e di që ne kemi gabuar që kemi miratuar gjithqka por gabimi mëi madhështë tëk kryetari.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar I Komunës.

Të nderuar anëtarë mua më duhet të dal sepse po vijnë komisionil bujqësisë. Sa I përket zjarrfiksave atje me të vërtetë ujë ka sepse është hapur një pus dhe duhet me u pastru ai pus. Pér dëmet e shkaktuara qytetarët kanë dhënë të dhëna jot ë sakta por komisioni po I bënë matjet e fushave me metër. Sevgi, edhe vjerri juaj ka ardhë pikërisht pér këtë qështje por aty janë anëtarët e komisionit edhe ata vendosin. Unë 90% jam I sigurt që pér shtëpi dhe ndërtesa nuk kanë me bërë pagesa. Përvëq kësaj trafot I kemi vendosur ne vende të shprazura dhe në vendet ku na është dhënë leje. Sa I përket diskutimeve krahasuar me komunat tjera ne jemi shumë mirë, ka edhe më keq. Unë asnjëherënu them që punët që po I udhëheqi unë në këtë komunë gjithmonë janë mirë. Të gjithë jemi këtu pér ti shërbyer popullit të Mamushës. Na ka ardhë edhe korniza e parë buxhetore dhe pasi që kemi mangut 28 nxënës kemi 208,000€ buxhet më pakë. Ne së bashku me drejtoret jemi duke u munduar që ta bindim Ministrinë e financave që buxhetin ta shtojmë. Neve vetëm pér pagat e shëndetësisë na shkojnë 210,000€. 193,000€ janë pér mallrat dhe shërbimet pér shëndeësi. Sa I përket qështjes së shëndetësisë unë dhe ekipi i jemi të gatshëm pér gjithqka, do të ndajmë mjete sa ka nevojë pér shëndetësi dhe arsim. Shëndetësia është gjëja më e rëndësishme pér ne, nëse nuk kemi shëndet atëherë kot I diskutojmë këto gjëra këtu. Më falni por mua më duhet të dal tani sepse kanë me ardhë anëtarët nga komisioni pér vlerësimin e dëmeve.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit pér pjesmarrje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek-----

